

Tiranë, më 07.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - SHËRBIM

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore të parkimit”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Vijëzime të rrugëve 34922100-7.

Vlera e fondit limit të marrëveshjes kuadër/ vlera e pritshme e kontratave : 14,499,739.43

(katërbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë pikë dyzetë e tre) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 24 (njëzetë e katër) muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Tirana Parking, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratës së përlllogaritur**, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: “40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar”, si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe në legjisllacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të **3 (tre) viteve të fundit** financiare (2022,2023,2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. (Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga **Pushteti Vendor për vitin 2025** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare, si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të

identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 (tre) viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si: referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **“Liçencë profesionale për veprimtari Ndërtuese Zbatimi”** të vlefshme për ofrimin e shërbimit, objekt prokurimi, lëshuar nga Komisioni

i Posaçëm i Dhënies së Liçencave Profesionale për Shoqëritë që ushtrojnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

- **NS – 6/A (Sinjalistika rrugore jondricuese)**

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 41 pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorisë së kërkuar, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e shërbimit objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Liçencë profesionale për kategorinë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku është përcaktuar kategoria dhe nënkategoria përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

N.S-6/A Sinjalistika rrugore jodricuese

Në Preventivin e përcaktuar për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me sinjalistika rrugore jodricuese si sinjalistike **vertikale** dhe **horizontale**, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategoria NS- 6 A, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë :

1.	Një makineri për aplikimin e bojës Bikomponente, APV
2.	Një makineri vijëzimi vetë-lëvizëse me bojë bikomponente
3.	Një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton
4.	Një kompresor i lëvizshëm

5.	Një gjenerator
6.	Dy copë set semaforësh për kontrollin e trafikut
7.	Një mjet për pastrimin e vijave/bojës ekzistuese
8.	Një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2-2.5 ton

Për të cilat duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm:

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; leje qarkullimi; çertifikata e kontrollit Teknik; siguracionin e mjetit (I vlefshëm), taksat vjetore si dhe lejen e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete që pajisen me leje transporti të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.

-Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; leje qarkullimi; çertifikatën e kontrollit Teknik; siguracionin e mjetit I vlefshëm; lejen e transportit të mallrave Brenda vendit për ato mjete që pajisen me leje transporti të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë me objekt të përcaktuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

-Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

-Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale të qerasë, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me TVSH (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset

sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për realizimin e shërbimit, për secilin zë. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Makineria për aplikimin e bojës bikomponente, APV është e nevojshme për aplikimin profesional të bojës bikomponente, e cila përdoret për sinjalistikë horizontale me qëndrueshmëri të lartë. Përdorimi i saj garanton trashësi dhe uniformitet të vijëzimit, rezistencë ndaj konsumit dhe kushteve atmosferike dhe jetëgjatësi më të madhe të sinjalistikës.

Makineria e vijëzimit vetë-lëvizëse mundëson realizimin e vijëzimit në mënyrë efikase dhe me produktivitet të lartë, duke ulur kohën e ndërhyrjes në rrugë, rritur saktësinë e aplikimit dhe minimizuar ndërhyrjen në qarkullimin rrugor.

Kamionçina me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton shërben për transportin e materialeve, pajisjeve dhe stafit në terren. Kapaciteti i kërkuar është i nevojshëm për të përballuar transportin e bojës, tabelave dhe pajisjeve ndihmëse dhe ndërhyrje të shpejta në zona të ndryshme.

Kompresori i lëvizshëm është i domosdoshëm për pastrimin e sipërfaqeve përpara aplikimit të bojës dhe funksionimin e pajisjeve pneumatike, duke siguruar cilësi më të lartë të aderencës së bojës.

Gjeneratori siguron furnizim të pavarur me energji elektrike në zonat ku mungon infrastruktura, duke mundësuar vazhdimësinë e punimeve pa ndërprerje dhe përdorimin e pajisjeve elektrike në çdo segment rrugor.

Seti i semaforëve për kontrollin e trafikut është i domosdoshëm për menaxhimin e qarkullimit gjatë punimeve, duke garantuar sigurinë e punëtorëve dhe përdoruesve të rrugës, shmangien e aksidenteve dhe organizimin e trafikut në mënyrë të kontrolluar.

Mjeti për pastrimin e vijave/bojës ekzistuese është i nevojshëm për heqjen e sinjalistikës së vjetër ose të dëmtuar dhe përgatitjen e sipërfaqes për vijëzim të ri, duke siguruar aderencë dhe cilësi optimale të aplikimit të ri.

Mjeti transportit ATV – karrotrec me kapacitet 2–2.5 ton është i përshtatshëm për transportin e mjeteve të dëmtuara ose pajisjeve në terren dhe ndërhyrje në zona me akses të vështirë duke rritur fleksibilitetin dhe shpejtësinë e reagimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf Teknik si më poshtë:

Nr.	Stafi Teknik
1.	Një inxhinier ndërtimi të diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi profili infrastrukturë transport. – natyra e punimeve është ndërtimore, pasi ka zhvendosje të tabelave të sinjalistikës, ndërtim bazamenti shtyllash për tabelat.

2	Një inxhinier mekanik me profil sinjalistikë dhe siguri rrugore – per percaktimin e llojit te tabelave ne rruge
3.	Dy manovradorë të pajisur me dëshmi kualifikimi si “Manovrador vijëzim asfalti” – per makinerite e vijeimit
4.	Dhjetë punonjës ndihmës.
5.	Një punonjës i certifikuar si “Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.
6.	Një punonjës i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) kontratën individuale të punës të vlefshme;
- b) një dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë) që të vërtetojë kualifikimin profesional si më sipër;
- c) të figurojë në listëpagesë jo më pak se 3 muaj.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarimin e mësipërm.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4) b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 41, pika 4) b).

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose..”

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Kërkesa për një inxhinier ndërtimi (profili infrastrukturë transporti) është e domosdoshme pasi natyra e punimeve përfshin zhvendosje dhe vendosje të tabelave të sinjalistikës rrugore, ndërtim të bazamenteve për shtyllat e tabelave dhe vlerësim të kushteve teknike të terrenit.

Kërkesa për një inxhinier mekanik me profil sinjalistikë dhe siguri rrugore kërkohet për përcaktimin e tipologjisë së sinjalistikës rrugore (tabela, materiale reflektuese, etj.), përshtatjen e sinjalistikës me kushtet e rrugës dhe standardet përkatëse dhe garantimin e funksionalitetit dhe efektivitetit të saj në rritjen e sigurisë rrugore. Prania e këtij specialisti siguron që ndërhyrjet të jenë teknike të sakta dhe në përputhje me normat e sigurisë rrugore.

Kërkesa për dy manovratorë të pajisur me dëshmi kualifikimi “Manovrator vijëzim asfalti” është e nevojshme për operimin e makinerive të specializuara të vijëzimit, të cilat kërkojnë aftësi teknike specifike, njohuri mbi parametrat e aplikimit të bojës dhe respektim të procedurave të sigurisë gjatë punës në rrugë.

Kërkesa për dhjetë punonjës ndihmës është i justifikuar nga shtrirja e punimeve në terren, nevoja për ndërhyrje të njëkohshme në disa segmente rrugore dhe realizimi në kohë i proceseve si vendosja e tabelave, sinjalizimi i përkohshëm dhe asistenca për makineritë. Ky staf është i domosdoshëm për mbështetjen operative dhe për garantimin e ritmit të punimeve.

Kërkesa për një punonjës i çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” është vendosur për të garantuar reagim të menjëhershëm në rast aksidenti apo incidenti në kantier, rritjen e nivelit të sigurisë për punonjësit dhe përdoruesit e rrugës dhe përputhje me kërkesat për sigurinë në punë.

Kërkesa për një punonjës i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” është thelbësor për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve gjatë punimeve në rrugë aktive, zbatimin e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve dhe respektimin e legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndërtimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 41, pika 4, gërma “c”.

Ky kriter është vendosur në funksion të garantimit të mbikëqyrjes profesionale dhe realizimit korrekt të punimeve, duke qenë se objekti i kontratës përfshin edhe ndërhyrje me natyrë ndërtimore. Punimet që parashikohen të realizohen përfshijnë ndërtimin e bazamenteve për vendosjen e tabelave, montimin dhe zhvendosjen e elementëve të sinjalistikës dhe ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese rrugore. Për këtë arsye, është e domosdoshme që këto procese të drejtohen nga një **inxhinier ndërtimi**, i cili garanton zbatim korrekt të projektit dhe specifikimeve teknike dhe cilësi dhe qëndrueshmëri të punimeve,

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë siguron që operatori ekonomik disponon realisht kapacitetin teknik të deklaruar dhe drejtuesi teknik është pjesë integrale e strukturës së operatorit dhe jo i angazhuar në mënyrë formale,

Deklarimi që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera është vendosur për të garantuar përkushtim të plotë të drejtuesit teknik ndaj kësaj kontrate dhe shmangien e mbivendosjes së angazhimeve që mund të ndikojnë në cilësinë dhe ritmin e punimeve,

Prania gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve është e nevojshme duke qenë se punimet kryhen në rrugë aktive dhe përfshijnë elementë sigurie rrugore, prania e drejtuesit teknik është e nevojshme për marrjen e vendimeve të menjëhershme teknike në terren dhe koordinimin e stafit dhe proceseve të punës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këto qellime, si më poshtë:

-SSH/ EN - ISO 9001:2015 në fushën e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 14001:2015 në fushën e menaxhimit mjedisor ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 45001:2018 në fushën e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 39001:2012 në fushën e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ose ekuivalente - Sistemi i menaxhimit mjedisor është i nevojshëm për shkak se aktivitetet e mirëmbajtjes përfshijnë përdorimin e materialeve kimike (bojëra, solventë) dhe ndërhyrje në mjedis gjatë punimeve në terren. Certifikimi garanton që operatori menaxhon ndikimin në mjedis, respekton kërkesat ligjore mjedisore dhe minimizon ndotjen dhe rreziqet mjedisore.

ISO 45001-2018 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ky standard është drejtpërdrejt i lidhur me objektin e kontratës, pasi sinjalistika rrugore është element kyç për sigurinë në trafik dhe çdo ndërhyrje e pasaktë mund të rrezikojë jetën e përdoruesve të rrugës.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit të autorizuar ose kontratë furnizimi për mallrat sipas preventivit.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si : telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në raste verifikimesh të mëtejshme. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit / distributorit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer e i noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e paraqitjes së autorizimeve nga një distributor, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar.

Argumentimi: Referuar nenit 77, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Si dhe pika 4, [...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.]

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...”

Autorizimi i prodhuesit/distributorit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike.

Materialet e përdorura për sinjalistikën rrugore (bojëra, tabela, adezivë) ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe qëndrueshmërinë e punimeve. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar garanton përdorimin e produkteve origjinale dhe të certifikuara, përputhshmëri me specifikimet teknike dhe akses në produkte të kontrolluara dhe të standardizuara.

Kërkesa që autorizimi të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit (telefon, e-mail, website, fax) është e domosdoshme për kryerjen e verifikimeve administrative dhe teknike dhe sigurimin që produktet janë reale dhe mund të konfirmohen në rast kontrolli, Në rast autorizimi nga distributor, verifikimi i lidhjes me prodhuesin garanton përdorim të materialeve të autorizuara dhe sigurinë dhe cilësinë e mallrave.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogë / fragmente të katalogëve të prodhuesit ose Skeda Teknike** për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilën të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen me logon e tij e ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe VKM-së nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 41, pika 6, ku cilësohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të përcaktuara me specifikimet teknike të paraqitura nga operatorët ekonomikë ofertues. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

Skeda teknike është një dokument që paraqet detaje specifike të mallrave të kërkuara më sipër dhe shërben për t'i dhënë garanci dhe siguri autoritetit kontraktor për ecurinë dhe realizimin e shërbimit në mënyrë të pandërprerë duhet të ketë përpunje me atë që është kërkuar në specifikimet teknike.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogëve të prodhuesit/eve jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth artikujve të kërkuar më sipër dhe në bazë të të cilit, autoriteti kontraktor mund të bëjë një vlerësim më të mirë të ofertave të paraqitura. Kërkesa për katalogë / skeda teknike është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe rëndësinë e kontratës (sinjalistika rrugore) dhe është proporcionale, duke siguruar vetëm informacionin minimal të nevojshëm për vlerësimin teknik.

2.3.9 Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesë mostrat per elementet e mëposhtëm sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambientet e Tirana Parking konkretisht:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia
1	Boje Akrelike e bardhe	25 kg
2	Boje Akrelike e verdhe	25 kg
3	Boje Akrelike blu	25 kg
4	Birila lavjerrës h=823mm	copë
5	Adeziv / Tabelë rezidenti	copë

Mostrat duhet të paraqiten me ambalazh origjinal.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të nenit 77, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 41, pika 6, ku cilësohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Materialet e kërkuara, si: bojë akrilike (e bardhë, e verdhë, blu), birila lavjerrës dhe adezivë/tabela janë elementë thelbësorë të sinjalistikës rrugore dhe ndikojnë drejtpërdrejt në dukshmërinë dhe lexueshmërinë e sinjalistikës dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës. Paraqitja e mostrave mundëson vlerësimin real të ngjyrës, reflektueshmërisë dhe përbërjes së bojës, cilësisë së materialeve plastike dhe rezistencës së tyre dhe përputhjes me specifikimet teknike të kërkuara. Mungesa e verifikimit paraprak të materialeve mund të sjellë përdorim të produkteve me cilësi të ulët dhe degradim të shpejtë të sinjalistikës, ndaj kërkesa për mostra minimizon këto rreziqe dhe garanton cilësi që në fazën e vlerësimit. Kërkesa për mostra është proporcionale me rëndësinë e kontratës dhe ndikimin në sigurinë rrugore dhe nuk është diskriminuese, pasi aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Shënim: 1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Specifikimet teknike dhe kriteret teknike të veçanta të kualifikimit janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave për procedurën me objekt “**Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore të parkimit**”, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, 2 dhe 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); grupi i punës hartoi specifikimet teknike për realizimin e objektit: **“Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore të parkimit”**, duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushës, në zbatim të detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, pas identifikimit të nevojave përgatiti specifikimet teknike dhe relacionin prezantues për realizimin e shërbimit.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, kërkesa të tjera të veçanta, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtarë të njësisë së prokurimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore të parkimit”**, Njësia e Prokurimit autorizoi një nga personat përgjegjës për prokurim.

Njësia e Prokurimit: